



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL.Anr. 63/20117

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Adnan Konushevci kryesues, Gyltene Sylejmani, Nenad Laziq anëtar, me pjesëmarrjen e Zyrtares Ligjore Arjeta Syla, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, të cilën e përfaqëson sipas autorizimit Blerim Sallahu, paraqitur kundër subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, për shkak të thyerjes së kodit të mirësjelljes-çrregullimit të tubimit te subjektit politik, për Zgjedhjet Lokale që do të mbahen me datë 22.10.2017, në seancën e panelit të mbajtur në prani të përfaqësuesit të subjektit politik LVV dhe në mungesë të përfaqësuesit të subjektit politik të LDK-së, të ftuar me rregull, pas përfundimit të seancës më datë 28.09.2017, mori këtë:

## V E N D I M

**REFUZOHEȚ** si e pabazuar ankesa e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, e cila identifikohet me shenjën ZL.Anr.63/2017 e datës 25.09.2017, me të cilën ka kërkuar që të ndërmerren veprimet ligjore kundër subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, për shkak të thyerjes së kodit të mirësjelljes për subjektet politike-çrregullimit të tubimit te subjektit politik, gjatë fushatës zgjedhore, për Zgjedhjet Lokale që do të mbahen me datë 22.10.2017.

## A r s y e t i m

Përfaqësuesi i parashtruesit të ankesës, si në ankesën e parashtruar PZAP, me datë 25.09.2017, gjatë shqyrimit të kësaj çështje në seancën e panelit të datës 28.09.2017, ashtu edhe në fjalën përfundimtare ka pretenduar se subjekti politik LVV është penguar me rastin e mbajtjes së tubimit publik me datë 24.09.2017, në fshatin Janjevë, Komuna e Lipjanit, Shkolla Filliore “Shtefan Gjeçovi”, sepse personi me emrin Albert Berisha, fotografia e të cilit gjendet në shkresat e lëndës e cila fotografi është marr nga facebook-u, e i cili me postimin e tij ka theksuar se kandidati për kryetar të LVV-së, nuk mund te hyj në Janjevë, për të mbajtur tubim publik, prandaj në ditën e mbajtjes së tubimit publik, kanë qenë prezent disa militant të LDK-së dhe fillimisht është penguar mbajtja e tubimit publik. Mirëpo Kandidati për kryetar të Komunës së Lipjanit nga subjekti politik LVV, me mirësjellje i ka larguar militantet nga klasa dhe ata gjatë daljes nga klasa ne korridor dhe në oborrin e shkollës kanë brohoritur “LDK, LDK” si dhe kanë përdorur fjalë të tjera fyeze dhe nxitëse. Prandaj, parashtruesi i ankesës konsideron se në rastin konkret kemi pas pengim për mbajtjen e tubimit publik. Me propozim për panelin që ankesa të aprovohet ne tërësi si e bazuar dhe te merren masa ndëshkuuese ndaj subjektit politik.

Paneli ka caktuar me datë 28.09.2017, seancë për shqyrtimin e kësaj çështje, mirëpo kryerësi i supozuar i thyerjes së kodit të mirësjelljes nuk ka prezantuar në seancë, ndërsa nga fletë kthesa e dorëzuar nga PZAP-i, është konstatuar se subjekti politik LDK, në cilësinë e kryerësit të supozuar të thyerjes së kodit të mirësjelljes, e ka pranuar ftesën për seancën e datës së lartpërmendur më datë 26.09.2017, por e njëjta nuk ka prezantuar në seancë dhe mungesën e tij nuk e ka arsyetuar, prandaj paneli konform nenit 423 par.4 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK), shqyrtimin e kësaj çështje e ka mbajtur në mungesë të kryerësi i supozuar të ftuar me rregull.

Kryerësi i supozuar i thyerjes së kodit të mirësjelljes subjekti politik LDK, në përgjigjen në ankesë të datës 26.09.2017, ka theksuar se ankesa e subjektit politik LVV, është tërësisht e pabazë dhe si e tillë duhet të hidhet poshtë, përfaktin se nuk përmban asnjë të dhënë përmes së cilës do të dëshmohej ndonjë shkelje nga strukturat e Degës së LDK-së në Lipjan, apo e ndonjë pjesëtari të këtyre strukturave. Ndërsa CD-ja të cilën pala ankuese ofron kinse si “dëshmi” për shkeljet e supozuara, thjesht nuk paraqet asgjë. Në foto shihet busti i “Shtefan Gjeçovi”, dhe disa vezë të hedhura në tokë dhe disa xhirime nga një tubim me plot zhurmë, e një deklarim i dikujt në kafe që më shumë mund të interpretohet si bisedë e lirë e qytetarëve të zakonshëm mbi kandidatët për komunën e tyre, gjë që është e drejtë e secilit të shprehet lirshëm në këtë vend, por që nuk ndërlidhet me LDK-në në asnjë rast. Me propozim për panelin që ankesa të refuzohet në tërësi si e pabazuar.

Paneli i PZAP-it, në këtë çështje juridike me qëllim të vërtetimi të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike shqyrtoi pretendimet e palëve në procedurë dhe provat si në vijim: Shikohet CD me Video nga vendi ku është mbajt tubimi publik, Shikohen 4 fotografi me ngjyra te formatit “A4” dhe Raporti i Policisë i datë 24.09.2017.

Paneli, pasi që shqyrtoj pretendimet ankimore provat e administruar secilën veç e veç dhe të gjitha së bashku, në kuptim të nenit 117 par.2 të LZP-së, gjeti se ankesa është e **pa bazuar**, përf këto arsyet:

Nga video CD-ja, që gjenden në shkresat e lëndës, paneli ka konstatuar se në një klasë të Shkollës Fillore “Shtefan Gjeçovi” në fshatin Janjevë Komuna e Lipjanit, kandidati për Kryetarë të Komunës në Lipjan, nga subjekti politik LVV, pas bisedës me disa persona në klasë, të njëjtit e kanë liruar vendin ku ishte duke mbajtur tubimi publik, subjekti politik VV, që njëri nga personat duke dal nga klasa edhe ka kërkuar falje. Më këtë video CD, nuk është vërtetuar me asnjë element-provë, se personat të cilët e kanë liruar vendin respektivisht klasën kanë qenë simpatizant apo mbështetës të subjektit politik LDK, sepse të njëjtit siç shihet në video-CD, nuk kanë poseduar asnjë shenjë, llogo apo material zgjedhor propagadistik të subjektit politik LDK dhe me CD nuk mund të vërtetohet se ndonjëri nga personat në fjalë ka brohoritur “LDK, LDK”, ashtu siç pretendohet në ankesë.

Paneli nga dy fotografit që gjenden në shkresat të lëndës qe shihen dy vezë të thyera në një vend të njëjtë, nuk mund të identifikohet se ku gjendet ai vend dhe kush janë personat që i kanë thyer ato vezë dhe përf çfarë qëllimi janë thyer. Më këto fotografi nuk mund të vërtetohen pretendimet e parashtruesit të ankesës së objekti që është mbajtur tubimi publik

për fushatë zgjedhore, është gjuajtur me vezë nga mbështetësit e subjektit politik LDK, sepse vezët e thyera gjenden në tokë “plato” e jo në objekt, siç pretendohet nga parashtruesi i ankesës.

Nga fotografia që gjendet në lëndë e që pretendohet se është në emër të Albert Berisha, dhe që përmban llogen e subjektit politik LDK, siç u pohua nga vetë përfaqësuesi i parashtruesit të ankesës në seancën e datës 28.09.2017, është fotografi e marr nga parashtruesi i ankesës në rrjetin social “facebook”, e nuk është fotografi e bëre në vendin ku pretendohet se është bëre pengimi i tubimit publik. Prandaj një provë e kësaj natyre nga paneli u vlerësua si jo relevante dhe e pa bazuar në ligj, sepse nuk ka fare të bëjë me vendin që është pretenduar se ka ndodhur pengimi për ta mbajtur tubimin publik.

Me raportin e policisë të datës 24.09.2017, paneli konstaton se gjatë mbajtjes së tubimit publik të subjektit politik LVV, në fshatin Janjevë, Komuna e Lipjanit, në shkollën filllore “Shtjefën Gjeçovi”, disa persona në moshë te re, në oborr të kësaj shkolle, kanë brohoritur LDK, LDK, më pas janë larguar dhe gjatë kontrollit në atë vend nuk ka pas asnjë dëm material të automjeteve apo gjësendeve tjera, vetëm se në tokë ka qenë e thyer një vezë dhe tubimi ka përfunduar i qetë dhe pa asnjë incident. Me këtë rast paneli nuk ka mundur ta vërteton se personat që kanë brohoritur LDK, LDK, në fakt a janë mbështetës të subjektit politik LDK, sepse nga raporti i lartpërmendor nuk është identifikuar asnjë person me emër dhe mbiemër dhe nuk është identifikuar asnjë person se cilët subjekti politik i përkasin, prandaj nga ky raport i policisë, i përpiluar në vend ngjarje, ka qenë pa ndikim për të vendosur ndryshe në këtë rast.

Paneli, për të vendosur dhe pranuar një ankesë si të bazuar vendimin e tij e mbështet në dëshmi të qarta dhe bindëse siç përcaktohet me nenin 117 par. 3 të LZP-së, ndërsa në këtë rast me provat e administruara, parashtruesi i ankesës nuk e ka bindur panelin me pretendimet dhe dëshmitë e prezantuara se ka ndodhur shkelja e pretenduar në ankesë. Për më tepër përfaqësuesi i parashtruesit të ankesës në seancën e datës 28.09.2017, ka deklaruar se pasi që janë larguar me mirëkuptim personat ne klasë, tubimi është mbajtur pa asnjë pengesë dhe në tërësi është përbushur agjenda e planifikuar.

Nga arsyet e theksuar më lart e duke bazuar nenin 118 par.1 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

### Paneli Zgjedhor për Ankesë dhe Parashtresë

Zl.Anr. 63/2017 më datën 28.09.2017

**Këshillë Juridik:** Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa në kuptim të nenit 118 par.4 të LZP-së, mirëpo PZAP-i, mund t'i rishikon cilindro nga vendimet e marra pas prezantimit të fakteve të reja nga pala e interesuar, në afat prej 24 orëve.

### Kryesuesi i Panelit

Adnan Konushevci

